VENDIM
Nr. 256, datë 25.3.2015

PËR KOMPENSIMIN PËR PRIVACIONET DHE HUMBJET QË I SHKAKTOHEN PUNONJËSIT TË POLICISË SË SHTETIT, PËR SHKAK TË NEVOJAVE TË PUNËS DHE TË SHËRBIMIT

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 29.6.2022)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 1, shkronjat "b" e "ç" dhe 2, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, kur emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme jashtë vendbanimit të tij, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi, si më poshtë vijon:

a) Nga 36 km deri 60 km, në masën 10 000 lekë në muaj;

b) Nga 61 km deri 100 km, në masën 15 000 lekë në muaj;

c) Nga 101 km deri 150 km, në masën 20 000 lekë në muaj;

ç) Nga 150 km deri 200 km, në masën 25 000 lekë në muaj;

d) Mbi 200 km, në masën 30 000 lekë në muaj.

2. Përfitimi i kësaj pagese vazhdon deri në ndryshimin e vendbanimit të punonjësit të policisë,që nënkupton sistemimin me banesë në territorin e juridiksionit të komisariatit të policisë apo drejtorisë së policisë së qarkut ku ai bën pjesë.

3. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 1, të këtij vendimi, punonjësi i policisë paraqet në organin ku *emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme,* dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesë me shkrim, pranë njësisë buxhetore ku është i punësuar punonjësi i policisë;

b) Fotokopje të kartës së identitetit, certifikatën e gjendjes civile familjare;

c) Vërtetim nga organi qeverisjes vendore, ku të vërtetohet vendbanimi i familjes dhe i vetë punonjësit të policisë, pavarësisht nga gjendja civile;

ç) Vërtetim pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme nëse punonjësi i policisë ka banesë në juridiksionin ku *emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme;*

d) Vërtetim pranë drejtorive të ALUIZNI-t nëse punonjësi i policisë ka aplikuar për legalizim banese në juridiksionin ku *emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme.*

4. Titullari i njësive shpenzuese të verifikojë nëpërmjet strukturave të tyre vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi i policisë.

5. Kur punonjësi i policisë *emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme* për nevoja pune dhe, për këtë shkak, bashkëshortja/i humbet marrëdhëniet e punës, në rast të pamundësisë së punësimit, i jepet një pagesë, deri në çastin e punësimit, në masën:

a) 50% të pagës mujore minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi pune mbi 1 vit dhe shtesë në masën 5%, të pagës mujore minimale në shkallë vendi, për çdo vit mbi 1 vit, por jo më shumë se paga minimale në shkallë vendi;

b) 100% të pagës mesatare mujore të vitit të fundit të punës, por jo më shumë se 150% të pagës minimale në shkallë vendi, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshortja/i ka vjetërsi në punë mbi 10 vjet.

6. Paga mesatare mujore e bashkëshortes/it të rritet sipas indeksit të pagës minimale, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

7. Vjetërsia në punë e bashkëshortes/it do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e

dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi/e, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhave të trajtimit me pagesë papunësie.

8. Përfitimi i pagesës, sipas pikës 5, të këtij vendimi, mund të përfitohet për një periudhë deri në 7 vjet.

9. Bashkëshortja/i, që ka përfituar sipas pikës 3, të vendimit nr. 183, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit", do të vazhdojë të përfitojë pagesën, sipas përcaktimeve të bëra në shkronjat "a" dhe "b", të këtij vendimi, por jo më shumë se 15 vjet.

10. Koha e qëndrimit pa punë e bashkëshortes/it të punonjësit të policisë llogaritet në vjetërsinë e përgjithshme të punës për efekt pensioni. Kontributi i sigurimeve derdhet nga institucioni dhe përfituesi sipas skemës së sigurimeve shoqërore për punonjësit civilë.

11. Për përfitimin e pagesës, sipas pikës 5, të këtij vendimi, punonjësi i policisë paraqet në organin, ku *emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme*, dokumentacionin e poshtëshënuar:

a) Kërkesë me shkrim, me gjenealitetet e plota, ku përshkruhet:

- organi ku ka punuar;
- data e transferimit;
- arsyeja e transferimit;
- adresa ku ka banuar;
- adresa aktuale ku banon pas transferimit;
- qendra e punës ku ka punuar bashkëshortja/i, data dhe shkaku i largimit nga puna.

b) Vërtetim të pagës mesatare mujore të vitit të fundit kalendarik të punës për pagesën e marrë nga bashkëshortja/bashkëshorti.

c) Vërtetim nga sigurimet shoqërore për kontributet e derdhura nga bashkëshorti/bashkëshortja për periudhën e punësimit.

ç) Librezën e punës së bashkëshortes/it, ku të jetë cilësuar largimi nga puna për arsye të transferimit të bashkëshortes/it.

d) Vërtetim nga zyra përkatëse e punësimit, ku të vërtetohet se bashkëshortja/i është regjistruar si punëkërkues i papunë dhe nuk i është ofruar punë në profesionin e saj/tij. Këtë vërtetim punonjësi e paraqet çdo tre muaj në zyrën e personelit.

dh) Kontratën e qirasë së banesës ku punonjësi *emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme.*

12. Në çdo 6 muaj, njësitë administrative buxhetore të Policisë së Shtetit të dërgojnë në zyrat rajonale të punësimit listën emërore të bashkëshortëv/eve, për trajtimin me përparësi nga këto zyra të punësimit të tyre, në rastet e hapjes së vendeve të lira.

13. Shfuqizuar.

14. Punonjësi i policisë, në përpjesëtim me kohën e shpenzuar gjatë ushtrimit të detyrës shtesë të trajnuesit në terren të punonjësve të policisë që kanë përfunduar periudhën e shkollimit në shkollën bazë të policisë, përfiton shtesë mbi pagën mujore në masën 40 lekë/orë, por jo më shumëse 7 000 (shtatë mijë) lekë.

15. Punonjësve të Policisë së Shtetit iu jepet ndihmë e menjëhershme financiare, në masën e një page mujore, në rastet e fatkeqësive në familje.

16. Pagesa i jepet punonjësit të policisë për rastet e vdekjes së një anëtari të familjes së tij (bashkëshorti/ja, prindërit apo fëmijët). Pagesa jepet me urdhër nga titullari i institucionit.

17. Masa e ndihmës financiare do të përballohet nga fondi i veçantë i institucionit.

18. Vendimi nr. 183, datë 9.2.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për kompensimin për privacionet dhe humbjet që i shkaktohen punonjësit të Policisë së Shtetit, për shkak të nevojave të punës dhe të shërbimit", shfuqizohet.

19. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Policisë së Shtetit.

20. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama